

VENDIM
Nr. 99, datë 4.2.2015

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2015, TË ENTIT
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për vitin 2015, për shumën 39 043 500 (tridhjetë e nëntë milionë e dyzet e tre mijë e pesëqind) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Pasqyra nr. 1

**PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR
VITIN 2015**

Nr .	Emërtimi i shpenzimeve	në lekë
1	Shpenzime për paga	23 166 500
2	Sigurime shoqërore	3 350 000
3	Shërbime e furnitura	11 290 000
4	Investime	1 237 000
TOTALI		39 043 500